VENDIM
Nr. 128, datë 29.10.2015

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "STRELCA ENERGY", SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "STRELCA 1" ME FUQI TË INSTALUAR 1504 KW, "STRELCA 2" ME FUQI TË INSTALUAR 325 KW DHE "STRELCA 3" ME FUQI TË INSTALUAR 3520 KW (ME FUQI TOTALE 5349 KW)

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", 39, pika 3 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1 germa "a"; 13 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Strelca Energy", sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3",

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë "Strelca Energy", sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Strelca Energy", sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Strelca 1" me fuqi të instaluar 1504 KW, "Strelca 2" me fuqi të instaluar 325 KW dhe "Strelca 3" me fuqi të instaluar 3520 KW (me fuqi totale 5349 KW).
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti